



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
REKTORI

Nr. 130 prot.

Tiranë, më 25/01 /2019

Lënda: Mbi ndryshimin e strukturës vjetore të procesit mësimor për vitin akademik 2018-2019

**Drejtuar:** Znj. Alma Sinanaj,  
Administratore e UART.  
Prof. Dr. Isak Shehu,  
Dekan Fakulteti i Muzikës.  
Prof. Petrit Malaj,  
Dekan Fakulteti i Artit Skenik.  
Prof. Asoc. Ardian Isufi,  
Dekan Fakulteti i Arteve të Bukura.  
Prof. Dr. Erald Bakalli  
Zëvendës rektor i anës mësimore

Këtu

Të nderuar,

Në vijim të diskutimeve të bëra në mbledhjen e fundit të Senatit Akademik si dhe propozimeve të Dekanëve të Fakulteteve në UART, për situatën në të cilën kaluam me bojkotin e studentëve në procesin mësimor, nisur nga shkresa me Nr. 1158/1 Prot., datë 28.09.2018 me lëndë *Struktura vjetore e procesit mësimor për vitin akademik 2018-2019*, aprovoj sugjerimin tuaj për një shtyrje të procesit mësimor prej dy javësh në semestrin e parë, sipas një kalendari të hartuar nga vetë Ju për secilin fakultet që drejtoni. Kjo shtyrje e afatit do të ndihmojë veçanërisht studentët për periudhën e humbur të procesit mësimor.

Ju lutem merrni masat e nevojshme duke Jua bërë të ditur si stafit akademik dhe studentëve, ndryshimet mbi zëvendësimin e procesit mësimor.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

REKTORI

Prof. Kastriot ÇAUSHI

UNIVERSITETI I ARTEVE

